

## **Hapet Thirrja e Dytë për Bursa për Stafin Akademik për Mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në Programin Erasmus + në Universitetin e Pavia, në Itali.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja e dytë për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Pavia, në Itali.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

### **Kohëzagjatja e bursave:**

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie, 5 ditë plus 2 ditë udhëtim, në periudhën 20 Shkurt 2017 – 31 Korrik 2018 (minimumi 8 orë mësimdhënie në javë)

### **Fushat e studimit:**

- Matematikë, Fizikë dhe Shkencat e Natyrës;
- Ekonomiks;
- Drejtësi;
- Gjuhë të Huaja dhe Filozofi;
- Shkenca Politike;
- Psikologji;
- Studime Komunikimi.

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

### **Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e Nevojshme për Aplikim:**

- Kandidati i interesuar përzgjedh një pedagog nga departamenti respektiv në Universitetin e Pavia për të shprehur interesin për të kryer një periudhë shkëmbimi duke dërguar përmes e-mail CV e tij/saj për të treguar fushën e ekspertizës dhe sesi të dy universitetet mund të përfitojnë nga ky aktivitet. Ju mund të gjeni të dhënat e kontaktit në adresën <http://www.unipv.eu/site/en/home/research/departments.html>
- Kandidati duhet të plotësojë dokumentin “Mobility agreement/Teaching programme” duke u konsultuar me pedagogun e përzgjedhur mbi aktivitetet që do të zhvillojë gjatë periudhës së shkëmbimit.
- Kandidati duhet të plotësojë aplikimin online në adresën <https://unipavia.pandaform.com/pub/wotpz/new>

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Dokumenti “Mobility agreement (teaching programme) i firmosur nga aplikanti dhe departamenti i Universitetit të Pavia dhe Universiteti i Tiranës\*\*\*;
- Një kopje të dokumentit të identifikimit (pasaportë);
- Vërtetim punësimi në Universitetin e Tiranës.

\*\*\* Dokumenti Mobility agreement/teaching programme *për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyri gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj si dhe nga Universiteti i Pavis.*

Për të shkarkuar formatin e Mobility agreement/teaching programme ju lutemi vizitoni: <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus-overseas/teaching-staff.html>

**Afati për aplikim: deri më datë 09 Janar 2017 (ora 12pm, sipas orës së Italisë)**

Per te aplikuar ju lutemi vizitoni:

<https://unipavia.pandaform.com/pub/wotpz/new>

Gjithë aplikimi është online.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni:

<http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus-overseas/teaching-staff.html>

ose kontaktoni me Znj. Elena Fontana në adresën: [erasmusoverseas@unipv.it](mailto:erasmusoverseas@unipv.it)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin Tuaj.